



## UDHËZIM PËR TENDER

**Emri i Marrësit të Shërbimit :** Organizata Përtej Barrierave (Beyond Barriers Association-BBA)

**Ref. no:** BBA 01/2023

**Ref. projektit:** “Green skills for youth with hearing impairment”

1. Organizata Përtej Barrierave, fton subjektet (tenderuesit) e kualifikuar të paraqesin një dokumentat e kerkuara për procedurën e prokurimit “Ndërtimin e një sere për të rinjtë me dëmtim të dëgjimit”, në kuadër të projektit “Green skills for youth with hearing impairment”.

Projekti mbështetet financiarisht nga Ambasada Kanadeze ne Rome përmes fondit te Iniciativave Lokale. Gjatë dorëzimit të dokumentacionit të tyre, tenderuesit duhet të ndjekin të gjitha udhëzimet, formularët, termat e referencës dhe specifikimet e përfshira në këtë dosje të tenderit.

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për dorëzimin dhe përzgjedhjen e ofertave.

1. Shërbimet që do të ofrohen Shërbimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor përshkruhen në termat e referencës.

### 2. Afatet

	<b>Data</b>	<b>Ora</b>
<b>Afati për të kërkuar sqarime nga autoriteti kontraktor</b>	13.09.2023	16:00
<b>Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave te tenderit</b>	18.09.2023	16:00
<b>Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave</b>	20.09.2023	-
<b>Njoftimi për fituesin e tenderit</b>	21.09.2023	-
<b>Nënshkrimi i kontratës</b>	23.09.2023	-
<b>Data e fillimit</b>	23.09.2023	-

### 3. Pjesëmarrja, ekspertë dhe nënkontraktetit

- a) Pjesëmarrja në këtë procedurë tenderimi është e hapur në kushte të barabarta për shoqëritë dhe personat fizikë, që janë të regjistruara dhe ushtrojnë këtë lloj veprimtarie në Shqipëri.
- b) Kualifikimi: Me plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes siç specifikohet në Termat e Referencës. te publikuar ne faqen zyrtare te organizates Pertej Barrierave ne website-in [www.beyondbarriers.org](http://www.beyondbarriers.org)



- c) Nënkontraktimi nuk lejohet.

#### **4.Përmbajtja e ofertes se tenderit**

Oferta duhet të përfshijë një ofertë teknike dhe një ofertë financiare, të cilat duhet të dorëzohen si dokumenta të veçantë brenda te njetit zarf.

##### **Oferta teknike**

##### **Oferta teknike përbëhet nga dokumentet e renditura më poshtë:**

- a) Shprehjen e interesit per te marre pjese ne tender te nënshkruar nga ofertuesi.
- b) Një formular të plotësuar identifikimin financiar, për të treguar llogarinë bankare në të cilën duhet të bëhen pagesat nëse tenderi është i suksesshëm.
- c) Kopje te ekstraktit historik, QKB
- d)Fotokopje e NIPT-it
- e) Prezantim i kompanisë dhe punës së saj
- f) Adresen zyrtare, person pergjigjes dhe kontaktet e plota.

Ofertuesve u kujtohet se dhënia e informacionit të rremë në këtë procedurë tenderimi mund të çojë në refuzimin e ofertës së tyre dhe në përjashtimin e tyre nga procedurat e tenderimit.

##### **Oferta financiare**

##### **Oferta financiare përbëhet nga dokumentet e renditura më poshtë:**

- a) Vërtetim për statusin aktiv të kompanisë.
- b) Dokumentin e plotësuar te bashkengjitur te ofertes financiare
- c) Pasqyra Financiare per periudhat 2021 dhe 2022.
- d) Draft projekti teknik dhe konstruktiv i serës (Plan 3D I serës)

Oferta financiare duhet të paraqitet si shumë në monedhën EUR.

Në ofertën financiare të dorëzuar do të përfshihet TVSH-ja.

Pagesat sipas kësaj kontrate do të bëhen në monedhen EUR.

#### **5.Informacione shtesë përpara afatit të fundit për dorëzimin e ofertave**

Ofertuesit mund të paraqesin pyetje me shkrim në adresën e mëposhtme përpara afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, duke specifikuar referencën e publikimit sipas afateve te paraqitura ne ToR.

e-mail: [office@beyondbarriers.org](mailto:office@beyondbarriers.org)

Autoriteti kontraktor nuk ka asnjë detyrim të japë sqarime për pyetjet e marra pas kësaj date.

Çdo ofertues që kërkon të organizojë takime individuale me autoritetin kontraktor në lidhje me këtë kontratë gjatë periudhës së tenderit mund të përjashtohet nga procedura e tenderit.

#### **6.Dorëzimi i dokumentave te tenderit**



Dokumentat e plote te tenderit duhet t'i dërgohen autoritetit kontraktor ne zarf te mbyllur brenda datës 18.09.2023, ora 16:00 ne zyrat e organizates Pertej Barrierave. Ato duhet të përfshijnë dokumentet e kërkuara si me sipër ne adresen e specifikuar ne ToR.

Ofertat duhet të dorëzohen duke përdorur sistemin e dosjeve/zarfave të dyfishta, d.m.th. në një zarf I cili përmban Brenda tij – Zarf me Oferten teknike" dhe zarfi tjetër - Oferten financiare".

Kujtojmë këtu se në rast se dorëzimi nuk kryhet sipas specifikimeve në këtë pike autoriteti kontraktues ka të drejtë të mos i marr ato në shqyrtim.

### **7.Ndryshimi ose tërheqja e operatoreve/kompanive**

Ofertuesit mund të ndryshojnë ose tërheqin ofertat e tyre me njoftim me shkrim përpara afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve.

Çdo njoftim i tillë i ndryshimit ose tërheqjes duhet të përgatitet dhe dorëzohet duhet të shënohet 'Amendament' ose 'Tërheqje' sipas rastit.

### **8.Shpenzimet për përgatitjen e tenderit**

Asnjë kosto e bërë nga tenderuesi në përgatitjen dhe dorëzimin e tenderit nuk është e rimbursueshme.

### **9.Vlerësimi i tenderit**

Hapja e ofertave të marra nuk është publike. Pasi autoriteti kontraktor të ketë hapur dokumentat e marra te tenderave, ato do të bëhen pronë e tij dhe do të trajtohen në mënyrë konfidenciale. Cilësia e ofertës teknike dhe financiare do të vlerësohet sipas kërkesave të përcaktuara në Termat e Referencës.

Pas verifikimit të përputhshmërisë teknike, do të hapen dokumentat me ofertat financiare për tenderët që nuk janë eliminuar gjatë vlerësimit teknik.

Qëllimi i procesit të vlerësimit financiar është të identifikojë ofertuesin që ofron çmimin më të ulët të njësisë/linjës midis ofertave teknikisht në përputhje me termat e references.

### **10. Perzgjedhja e fituesit te tenderit**

Komisioni i vleresimit te tenderimit i perbere prej 3 personash, do te mblidhet ne dt. 20.09.2023. ora 11:00 dhe ju do te njoftoheni per rezultatin e vleresimit brenda dates 21.09.2023. permes e-mailit, me njoftim zyrtar.



## **11. Kriteret e perzgjedhjes**

Perzgjedhja e fituesit te tenderit do te behet bazuar mbi keto kritere, te vleresuara ne pike:

- Oferta teknike – 40 pike
- Oferta financiare – 60 pike

Permbushja e kushteve teknike eshte domosdoshmeri. Ofruesi duhet te marre minimum 20 pike tek oferta teknike.

## **12. Konfidencialiteti**

E gjithë procedura e vlerësimit është konfidenciale, duke iu nënshtruar legjislacionit të autoritetit kontraktor për aksesin në dokumente.

Vendimet e komisionit vlerësues janë kolektive dhe shqyrtimi i tij mbahet në seancë të mbyllur.

Anëtarët e komisionit vlerësues janë të detyruar të ruajnë sekretin.

Raportet e vlerësimit dhe të dhënat me shkrim janë vetëm për përdorim zyrtar dhe nuk mund t'u komunikohen as ofertuesve dhe as ndonjë pale tjetër përveç autoritetit kontraktor

## **13. Klauzolat etike dhe kodi i sjelljes**

Ofertuesi nuk duhet të ndikohet nga ndonjë konflikt interesi dhe nuk duhet të ketë asnjë lidhje të barabartë në këtë drejtim me ofertuesit e tjerë ose palët e përfshira në projekt.

Çdo përpjekje e një ofertuesi për të marrë informacion konfidencial, për të hyrë në marrëveshje të paligjshme me konkurrentët ose për të ndikuar në komisionin e vlerësimit ose autoritetin kontraktor gjatë procesit të shqyrtimit, sqarimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve do të çojë në refuzimin e ofertës së tij dhe mund të rezultojë në administrative

Çdo përpjekje e një ofertuesi për të marrë informacion konfidencial, për të hyrë në marrëveshje të paligjshme me konkurrentët ose për të ndikuar në komisionin e vlerësimit ose autoritetin kontraktor gjatë procesit të shqyrtimit, sqarimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve do të çojë në refuzimin e ofertës së tij dhe mund të rezultojë në refuzimin e tenderit të tij.

Respektimi i të drejtave të njeriut si dhe legjislacionit mjedisor dhe standardeve bazë të punës Tenderuesi dhe personeli i tij duhet të respektojnë të drejtat e njeriut dhe rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave.

Tenderuesi duhet të jetë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret dhe kodet në fuqi në lidhje me anti-ryshfetin dhe kundër korrupsionit.

Shkelje detyrimesh, parregullsi ose mashtrim Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të pezullojë ose anulojë procedurën, kur procedura e dhënies së kontratës rezulton se ka qenë objekt i shkeljes së detyrimeve, parregullsive ose mashtrimit.

Tenderuesit do të njoftohen me shkrim për rezultatin e kësaj procedure të prokurimit.



Autoriteti kontraktues për më tepër, në të njëjtën kohë, do të informojë edhe tenderuesit e mbetur të pasuksesshëm për rezultatin e procedurës së prokurimit dhe, si pasojë e këtyre letrave, vlefshmëria e ofertave të tyre nuk do të ruhet.

#### **14. Anulimi i procedurës së tenderit**

Në rast të anulimit të procedurës së tenderit, autoriteti kontraktor do të njoftojë tenderuesit për anulimin.

Anulimi mund të ndodhë, për shembull, kur:

- procedura e tenderit ka qenë e pasuksesshme, d.m.th. nuk është marrë asnjë ofertë e përshtatshme, cilësore ose financiarisht e pranueshme ose nuk ka fare përgjigje të vlefshme;
- ka ndryshime thelbësore në të dhënat ekonomike ose teknike të projektit;
- rrethanat e jashtëzakonshme ose forca madhore e bëjnë të pamundur zbatimin normal të kontratës;
- të gjithë tenderët teknikisht të pranueshëm tejkalojnë burimet financiare në dispozicion;
- ka pasur shkelje të detyrimeve, parregullsi ose mashtrime në procedurë, veçanërisht nëse ato kanë penguar konkurrencën e ndershme;
- shpërblimi nuk është në përputhje me menaxhimin e shëndoshë financiar, d.m.th. nuk respekton parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit